



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2020:005716

Datë: 21.03.2024

Numri i dokumentit: 05485239

Ac.nr.7927/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, kolegji në përbërje nga gjyqtari Besnik Bislimaj– kryetar i kolegjit dhe gjyqtarëve Faton Ademi dhe Adnan Konushefci, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit, M. S. nga Prishtina, të cilin e përfaqëson me autorizim Mentor Neziri, avokat në Prishtinë, kundër të paditurës, Kompania e Sigurimeve “Siguria”, në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Labinot Buzuku av. nga Prishtina, për kompensimin e dëmit material dhe jo material, vlera e kontestit 601,223.72 euro, duke vendosur sipas ankesave të paditësit dhe të paditurës, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.667/2013 datë 02.06.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 12.03.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

I. PJESËRISHT aprovohet si e bazuar ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve Siguria me seli në Prishtinë dhe Pjesërisht refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit M. S. nga Prishtina, NDRYSHOHET pika I dhe II e aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.667/2013 datë 02.06.2021, sa i përket dëmit jo material dhe dëmit material për ushqim të përforcuar dhe çështja tani gjykohet si në vijim: DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “Siguria” me seli në Prishtinë, që në emër të dëmit jo material, si pasojë e aksidentit të shkaktuar me datën 23.09.2012, paditësit M. S. nga Prishtina t’ia kompensoj shumat si në vijim: për dhimbjet e përjetuara fizike shumë prej 5,000.00 euro, për frikë të përjetuar shumë prej 4,000.00 Euro; për dhimbjet shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallë prej 35% shumë prej 16.000,00 Euro, për shëmtim truporë shumë prej 4,000.00 euro si dhe dëmin material për ushqim të përforcuar shumë prej 1,200.00 euro, me kamatë ligjore si për mjetet e depozituara në Bankat Afariste në Kosovë dhe atë duke filluar nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi me datë 19.05.2021 e gjer në pagesën definitive. Pjesa tjetër e kërkesë padisë së paditësit, përtej shumave të gjykuara e deri në shumat e kërkuara për këto kategori të dëmit, refuzohen si të pa bazuar.

II. PJESËRISHT aprovohen si të bazuara ankesat e paditësit M. S. nga Prishtina dhe të paditurës Kompania e Sigurimeve Siguria me seli në Prishtinë, ashtu që aktgjykimi Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.667/2013 datë 02.06.2021, në pikën I të dispozitivit sa i përket kompensimit të dëmit material për ndihmën e personit të tretë, fitimit të humbur – rentës dhe pikën II sa i përket shpenzimeve të shërimit, shpenzimeve për terapi fizikale si dhe pika III e dispozitivit sa i përket shpenzimeve të procedurës, prishet dhe çështja kthehet në ri procedurë dhe ri vendosje.

### A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar C.nr.667/2013 datë 02.06.2021, ka vendosur: APROVOHET PJESËRISHTË SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit M. S. nga Prishtina. I.DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “Siguria” në Prishtinë, që paditësit M. S. nga Prishtina, në emër të kompensimit të dëmit jomaterial dhe material, t’ia paguajë shumat e specifikuar si me poshtë:

-Në emër të dëmit jomaterial:

- Për dhimbje të përjetuara fizike, shumën prej .....6,000.00 euro
- Për frikë të përjetuar, shumën prej.....5,000.00 euro
- Për shëmtim trupor, shumën prej.....6,000.00 euro
- Për zvogëlim te aktivitetit te përgjithshëm jetësor, shumën prej .....17.000.00 euro.

Në emër të dëmit material:

- Për ushqim te përforcuar shumën prej .....1,800.00 euro
- Për ndihmën e kujdesit të huaj, për periudhën e kaluar prej aksidentit 23.09.2012 e deri ne ditën e nxjerrjes së ekspertizës datë 31.03.2021, shumën prej 15,892.86. Ndërsa për periudhën e ardhshme prej 01.04.2021 e deri sa për këtë te ekzistojnë kushtet ligjore nga 150 euro në muaj.
- Në emër të kompensimit të dëmit për fitimin e humbur-renta, për periudhën e kaluar prej 12.12.2012 kur ai pas aksidentit të datës 23.09.2012, e deri me datë 31.07.2019 datë kur është përpiluar ekspertiza, ne shumën prej 9,155.78 euro. Për periudhën e ardhshme prej 01.08.2019 e tutje deri sa te ekzistojnë kushtet ligjore ne shumën prej R=128.35 euro.

II. REFUZOHET SI E PABAZUAR, kërkesëpadia e paditësit, për kompensimin e dëmit material dhe jo material përtej shumave te gjykuara si ne pikën I te dispozitivit te këtij aktgjykimi, për shumat si ne vijim: për dhimbje të përjetuara fizike, shumën prej 134.000.00 euro, për frikë të përjetuar shumën prej 135.000.00 euro, për shëmtim trupor, shumën prej 54,00.00 euro, për zvogëlim te aktivitetit te përgjithshëm jetësor shumën prej 83.000.00 euro për ushqim te përforcuar shumën prej 18.200.00 euro , për ndihmën e kujdesit të huaj përtej shumës së gjykuar për shumën e kapitalizuar. Refuzohet në tersi në emër të medikamenteve terapive fizikale, shumën prej 25,000.00 euro dhe në emër të shpenzimeve për rehabilitim fizioterapik shumën prej 5000 euro. Refuzohet përtej shumës së gjykuar në emër të kompensimit të dëmit për fitimin e humbur renta shumën e kapitalizuar.

III. DETYROHET, e paditura Kompania e Sigurimeve “Siguria” në Prishtinë, që paditësit shumat e gjykuara të specifikuara si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, shumat e gjykuara të specifikuara si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, t’ia paguajnë me kamatë ligjore si për mjetet e depozituara në Bankat Afariste në Kosovë dhe atë duke filluar nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi me datë 19.05.2021 e gjer në pagesën definitive, si dhe t’ia paguaj edhe shpenzimet procedurale në shumën prej 2,713.00 euro, e të gjitha këto me se largu në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përbarimit ligjor.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin e paraparë ligjor, e paditura, ka parashtruar ankesë, për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit që të aprovoj ankesën e paditësit si të bazuar dhe ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar ashtu që ta aprovoj në tërësi si të bazuar kërkesë padinë e paditësit të specifikuar si në ankesën e parashtruar me shkrim.

Gjithashtu, kundër këtij aktgjykimi, në afatin e paraparë ligjorë, e paditura ka paraqitur ankesë për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit në Prishtinë, që të aprovohet ankesa si e bazuar dhe ta prishë aktgjykimin e ankimuar dhe lëndën ta kthej në ri procedurë dhe ri vendosje.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-ankesa e paditësit është pjesërisht e bazuar.

-ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “Siguria” është e pjesërisht e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi M. S. nga Prishtina, me datë 31.12.2013, në gjykatën e shkallës së parë ka parashtruar padi kundër të paditurës, Kompania e Sigurimeve “Siguria” me seli në Prishtinë, për kompensim të dëmit material dhe jo material, të cilën kërkesë paditësit e ka precizuar me parashtrësën e dorëzuar me shkrim, konkretisht si në të njëjtën parashtrësë.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësit, ka mbajtur shqyrtimin kryesore, pas deklarimit të palëve ndërgjyqëse, administrimit të provave, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar C.nr. 667/2013 datë 02.06.2021, me të cilin ka vendosur që të aprovohet pjesërisht kërkesëpadija e paditësit, duke vendosur me saktësisht si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ndër të tjera ka theksuar se: Nga ekspertiza mjekësore e punuar nga ekspertët gjyqësor Dr. Xh. S. ortoped traumatolog, Dr. Sh. D. neurokirurg dhe Dr. F. D. neuropsikiatër, Gjykata gjeti se paditësi, në këtë rast i dëmtuari, me rastin e aksidentit në komunikacion me datë 23.09.2012, ka pësuar këto lëndime: Meamatoma intracerebralis acuta reg. T-P lat.sin. (Gjakderdhje mbrendatrunore akute ne

regjionin temporo-parietal djathtas). Heamatomia epiduralis ac. Reg.T-B lat.dex. (Gjakderdhje mbidurale akute ne regjionin temporo-bazal djathtas. Fractura cranii linearis reg.T-lat.dex.)thyerje lineare e ashtit temporal djathtas). Excoriatio cutis reg.P-T lat.dex. (Gervishje e lëkurës në regjionin parieto-temotal djathtas). Epi post-traumatica (Epilepsi pastramatike). Hypoacusis lat.dex. (Laessio n.cochlearis lat.dex.). Zvogëlim i dëgjimit me veshin e djathtë përshkak të lëndimit të nervit te dëgjimit djathtas. Hemianopsia homonima dex. (Dobësim i të pamurit në syrin e djathtë). Sy.vertiginosum (marramendje). Dg. Përfundimtare “Dg. Hematoma intracerebralis acuta reg. T-P lat.sin (Gjakderdhje brendatrunore akute), Fractura cranii linearis reg. T- lat.dex. Hematoma epiduralis acuta reg. T-B lat.dex. Epi post-traumatica (Epilepsi), Hypoacusis lat.dex. (Laessio n.cochlearis lat.dex), Hemioanopsia homonima lat.dex. Sy. Vertiginosum. Op: Craniotomia osteoclastica reg.temporo-parietalissin. Et evacuatio haematoma intracerebralis reg.uisd. drainage subgaleatica. Op: Cranioplastica cum operculi ossei reg. P-T lat.sin. Këto lëndime klasifikohen si lëndime të rënda, trupore të cilat kanë shkaktuar: Dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë e cila ka zgjatur disa sekonda, dhimbje fizike të intensitetit të rëndë për 7 ditë, kohë pas kohe deri sa ka marr terapinë adekuate, qëndrimi në Klinikë. Dhimbje fizike të intensitetit të mesëm për 30 ditë, për shkak të mungesës së ashtit dhe nevoja për adaptimin e trurit pa mbrojtësin kockor i cili është konservuar në nënlëkurën e barkut (për ti lejuar trurit hapësirë për shkak të enjtes). Si dhe dhimbje fizike të intensitetit të ulët të cilat i ka edhe sot e kësaj dite, të manifestuara si kokëdhimbje, dhimbje e ekstremiteteve në sforcime fizike dhe ne ndryshime klimatike.

Më tej ka arsyetuar se: Frikë primare, ka qenë me vetëdije të turbullte dhe shpejt e kishte humbur vetëdijen. Në këtë mënyrë përjashtohet përjetimi i frikës primare. Frikë sekondare të intensitetit të lartë, e cila nënkupton preokupimin me gjendjen. Pastaj ankthin, frikën, ndotjen se mos po ndodh diçka e rëndë dhe e rrezikshme për jetën e tij. Këto gjykime dhe ndjenja te njëjtit i paraqiten pas kthjelljes se vetëdijes, ku i njëjti e kupton se ku gjendët dhe çka është duke ndodhur, ne aspektin e trajtimit mjekësor. Te gjitha këto shqetësime qojnë ne konstatimin se i njëjti e ka përjetuar frikën sekondare të intensitetit të lartë e cila ka zgjatur 14 ditë, koha deri sa ka dal nga spitali. Frikë sekondare e intensitetit mesatar, ka vazhduar me barnat, kontrollat, ku kishte siklete, pagjumësi, dhimbje , mërzi. Kjo frikë e intensitetit mesatar ka zgjatur për 6 muaj. Si dhe frikë sekondare të intensitetit të ulët për 6 muaj të tjerë.

Më tej ka theksuar se: Zvogëlimi i aktivitetit të përgjithshëm jetësor është i shprehur në shkallën prej 35% - për shkak të lëndimit morfologjik të trurit, të përcjellura me marramendje, çrregullim te drejtpeshimit, lëndim te nervave kranial (nervit te të pamurit dhe dëgjimit), si dhe paraqitjes se sulmeve epiletike, P.1.1.4 e tabelës mbi zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor. Shëmtimi trupor është i shkallës së mesme për shkak të vrazës operatore me gjatësi 20cm ne formë të patkojit te kthyer përmbys; tri vrazave te tjera ne pjesën e jashtme te krahut te djathte përmasa: 1cm, 3.5cm dhe 2x1cm si dhe vrazës operatore ne anën e majtë të barkut me gjatësi prej 8cm. Për shkak te konservimit te kockës tepo-tembelore te kokës. Ndihma dhe kujdesi i huaj ka qenë i domosdoshëm për 90 ditë, ndihmë e cila konsiston ne përgatitjen dhe ofrimin e ushqimit si dhe ne mbajtjen e hixhienes personale, ne hapësirat jashtë shtëpisë ka nevojë për përkujdesje për shkak të mundësisë së ndonjë sulmi epileptik. Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 120 ditë, i pasur me vitamina, minerale, yndyra të pangopura, proteina dhe

albumina. Rehabilitimi fizioterapeutik ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje tri herë nga 10 ditë për vitin e parë dhe dy herë nga 10 ditë tjera për vitin e dytë pas lëndimit.

Më tej ka theksuar se: Nga ekspertiza e mjekësisë së punës nga eksperti dr. Kujtim Zajmi, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi si pasojë e aksidentin e ka të zvogëluar aktivitetin punues në 42.5 %, që nënkupton se është i paafte për kryerjen e punëve që kërkojnë aktivitete fizike ky hyjnë në funksion gjymtyrët e sipërme, dhe punët që kërkojnë lëvizje fine dhe qëndrim të gjatë në këmbë. Më tej ka theksuar se: Nga ekspertiza e aktuaristikës e punuar nga eksperti Aziz Berisha, lidhur më së pari me material të formës së fitimit të humbur – rentës së palës paditëse, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi si pasojë e aksidentin ka pësuar lëndime në aksidentin e komunikacionit përpos të llojeve të dëmit tjetër i takon edhe e drejta e kompensimit të dëmit material të formës së fitimit të humbur – rentës, e cila arrin vlerën prej: për periudhën e kaluar prej 12.12.2012 kur ai pas aksidentit të datës 23.09.2012 kur ai ka mbushur 18 vjet moshe e deri me tani ditën e ekspertizës 31.07.2019, date e cila konsiderohet si kryerje e kësaj ekspertize ne shumën prej 9,155.78 euro, që së bashku me kamatën e llogaritur me nome prej 8 % në vit e sipas arritjes mujore për pagese prej datës së ushtrimit të padisë, e deri me datën e ekspertizës 31.07.2019 shumen prej 2,282.67 euro, arrin në gjithsejtë shumën prej 11,438.45 euro. Periudhën e ardhshme prej 01.08.2019 e tutje deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore ne shumën prej 128.35 euro, e cila e paguar ne formë të menjëhershme të kapitalizuar arrin vlerën prej 32,650.39 euro, pra shume e gjithmbarshme për periudhën e kaluar se bashku me kamatën dhe periudha e ardhshme e paguar ne forme te menjëhershme të kapitalizuar arrin vlerën prej 9,155.78 euro, plus kamata 2,282.67 euro plus 32.650.39 = 40,088.84 euro. gjithashtu nga plotësim ekspertiza e aktuaristikës e datës 22.03.2021, gjykata ka vlerësuar se paditësi ka nevojë për ndihmën e personit të tretë, i cili dem arrin vlerën prej: për periudhën e aksidentit 23.09.2012 e deri ne ditën e nxjerrjes së këtij mendimi data 31.03.2021, në shumën prej 15,892.86 euro që së bashku me kamatë prej 8% prej ditës së ushtrimit të padisë e deri me datën 31.02.2021 shumën prej 5,738.02 euro, gjithsejtë shumën prej 21,567.88 euro. Dhe për periudhën e ardhshme prej 01.04.2021 e deri sa për këtë të ekzistojnë kushtet ligjore nga 150 euro në muaj e cila e paguar në formë të menjëhershme të kapitalizuar arrin shumen 45,504.00 euro. Shuma e gjithmbarshme e ndihmës dhe kujdesit të huaj për periudhën e kaluar se bashku me kamatën dhe për periudhën e ardhshme e paguar ne forme te menjëhershme të kapitalizuar arrin në shumën prej 15,892.96 euro + kamatat 5,738.02+ 45,504.00 euro=67,134,88 euro. Kjo llogaritje vlen me kusht që paditësi të mos jete përfitues i pensionit ne cilësi të personit me aftësi të kufizuara nga Departamenti i Administratës Pensionale te Ministrisë se Punës dhe Mirëqenies Sociale. Me këtë rast, gjykata pati parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimin të cilit i shërben kompensimi i gjykuar, gjithmonë duke pasur parasysh që kompensimi të jetë satisfaksion për të dëmtuarin-paditësin, duke ndikuar kështu në zbutjen e pasojave negative që janë paraqitur si pasojë e dëmit në cenimin e vlerave personale të paditësit.

Më tej ka theksuar se: Gjykata pasi konstatoj rrethanat e rastit duke pasur parasysh, natyrën e lëndimit, me pasoja të shfaqjes së dhimbjeve në periudha siç janë vlerësuar në ekspertizë sidomos intensitetin e dhimbjeve, periudhën e kohëzgjatjes së frikës dhe intensitetin e frikës, e duke i marrë për bazë edhe rrethanat tjera që ndikojnë në përcaktimin e lartësisë së kompensimit, në këtë rast frikën e paditësit se dhimbjet fizikë mund të jenë rezultat i ndonjë sëmundje të rëndë e

rrjedhimisht edhe frikën sipas këtyre vlerësimeve, pastaj moshën e të dëmtuarit, praktikën e mirë gjyqësore, (që i referohet lartësisë së kompensimit), vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit në pjesën e aprovuar.

Më tej ka theksuar se: Për pjesën të kërkesëpadisë e refuzuar përtej shumës së gjykuar, që ndërlidhet me dëmin jomaterial dhe material, gjegjësisht për dhimbje fizike, shumën prej 134.000.00 euro, për frikë të përjetuar shumen prej 135.000.00 euro, për shëmtim trupor, shumën prej 54,00.00 euro dhe për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumen prej 83.000.00 euro, për ushqim të përforcuar shumen prej 18.200.00 euro, për ndihmën e kujdesit të huaj përtej shumës së gjykuar për shumën e kapitalizuar, dhe në emër të kompensimit të dëmit për fitimin e humbur renta shumën e kapitalizuar, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që vlerësoj se kompensimi përtej shumës së gjykuar, nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur dhe me qëllimin që kompensimi të ishte i drejtë, dhe se lartësia e kërkesës për këtë lloj të dëmit është tejet e lartë dhe në kundërshtim me provat e administruara (mendimin e ekspertëve mjekësor dhe praktikën gjyqësore).

Lidhur me mënyrën e vendosjes, gjykata e shkallës së parë është mbështetur në dispozitat e nenit 154, 155, 158, 178.1, 189, 195 dhe 200 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Në lidhje me kamatën është vendosur në kuptim të nenit 277 të LMD-së së vitit 1978.

Lidhur me vendimin mbi shpenzimet e procedurës është vendosur në kuptim të nenit 449, 452 dhe 463 të LPK-se.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i Gjykatës së shkallës së parë është pjesërisht i drejtë dhe i ligjshëm në pjesën e ndryshuar, pasi që Aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, drejtë dhe në mënyrë të plotë është vërtetuar gjendja faktike, mirëpo e drejta materiale pjesërisht është zbatuar në mënyrë të gabuar. Gjithashtu aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palëve ndërgjyqëse se Aktgjykimi në pjesën e ndryshuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i Aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë dhe i ekzaminueshëm, e në përputhje të plotë me arsyet e Aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike i dispozitivit me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Po ashtu Gjykata e Apelit i vlerëson si të pa qëndrueshme pretendimet ankimore të paditësit dhe të paditurës për vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike në pjesën e ndryshuar të aktgjykimit të ankimuar. Pasi që nga provat që gjinden në shkresat e lëndës, të cilave dhe ja bali besimin e plotë edhe gjykatë së Apelit i rezulton e njëjta gjendje faktike e vërtetuar si ajo e gjykatës së shkallës së parë. Pasi që pa mëdyshje është vërtetuar se ekziston përgjegjësia e të paditurave për kompensimin e dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 23.09.2012, i cili dëm është shkaktuar me fajin e të siguarve të të paditurave gjë që të paditurat nuk e ka kontestuar bazën juridike në kuptim të ndodhjes së aksidentit por të njëjtat e kanë kontestuar në kuptim të shkallës së përgjegjësisë. Ndërsa gjykata e shkallës së parë lartësinë e kërkesës e ka bazuar në mendimin e ekspertëve Dr. Xh. S. Ortoped- traumatolog, Dr. Sh. D., Neurokirurg si dhe Dr. F. D. Psikiatër, të cilët kanë dhënë mendimin e tyre profesional në lidhje me natyrën e lëndimeve trupore, dhimbjeve fizike, frikës së përjetuar, shëmtimit truporë si dhe zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësorë, e që gjykata e shkallës së parë në bazë të këtyre mendimeve ka përcaktuar edhe lartësinë e kompensimit të dëmit jo material të vendosur si në dispozitiv nën I të aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se është zbatuar pjesërisht në mënyrë të gabuar e drejta materiale nga gjykata e shkallës së parë në pjesën e ndryshuar të aktgjykimit të ankimuar kur janë gjykuar shumat për dëmin jo material në emër të dhimbjeve fizike, frikës së përjetuar, shëmtimit truporë dhe zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësorë si dhe dëmin material për ushqim të përforcuar. Gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar dispozitën e nenit 183 të LMD-së. Pasi që për këtë kategori të dëmit shumat janë të larta dhe nuk paraqesin kompensim realë për kompensimin e dëmit dhe as nuk janë në pajtueshmëri as me praktikën gjyqësore si dhe udhëzuesin e Gjykatës Supreme të Kosovës me nr. 41/2023 të datës 27.02.2023, pasi që të njëjtat shuma tejkalojnë qëllimin e kompensimit për të dëmtuarin e në rastin konkret për paditësin, prandaj gjykata e shkallës së dytë e aprovoi pjesërisht ankesën e të paditurës, ndryshoi aktgjykimin e ankimuar pjesërisht për këto kategori të dëmit dhe gjykoji si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke vlerësuar se shumat e aprovuara nga gjykata e shkallës së parë për format e kompensimit të dëmit jo material nuk bazohen në kriteret e zbatueshme për vlerësim, e as në praktikën gjyqësore të krijuar nga gjykatat e Kosovës për këto forma të shpërblimit të dëmit dhe as në natyrën dhe llojin e së mirës së dëmtuar.

Gjykata e Apelit, vlerëson se shumat e gjykuar si në dispozitivin nën I të aktgjykimit të shkallës së dytë janë adekuate me kriteret dhe qëllimin e përcaktuar me nenin 183 të LMD, këto shumat përfaqësojnë një satisfaksion adekuat që i dëmtuari t'i përballojë më lehtë dëmin jo materiale të pësuar edhe pse kjo formë të dëmit nuk mund të vlerësohen e as të kompensohen me para. Me paragrafin 2 të nenit 183 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve përcaktohet se me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jo material, si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, e gjithashtu edhe për faktin se të mos u shkojë përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror". Pra, nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore rezulton se kompensimi duhet të jetë adekuat me natyrën e lëndimit, dhimbjeve fizike, frikën e përjetuar, shëmtimin trupor, zvogëlimin të aktivitetit jetësor, ashtu që kompensimi të përfaqësojë një lehtësim në përbalimin e tejkallimit të pasojave të dëmit. Shuma e gjykuar nga

gjkata e shkallës së dytë si në pikën I të dispozitiv të këtij aktgjykimi është reale dhe paraqet satisfacion të vërtet dhe u shkojnë për shtati synimeve shoqërore për kompensimin e demit. Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes mori parasysh të gjitha rrethanat siç janë: moshën e paditësit, intensitetin e frikës së përjetuar, shkallën e zvogëlimit të aktivitetit jetësor në lartësi prej 35% e konstatuar nga mendimi i ekspertëve të cekur më lartë si dhe praktikën gjyqësore të krijuar gjerë më tani e gjithashtu udhëzuesin e Gjykatës Supreme të Kosovës me nr. 41/2023 të datës 27.02.2023 sa i përket shpërblimit të demit për këto kategori të demit. Gjithashtu gjykata e Apelit vlerëson se shumica e gjykuar si në dispozitiv nën I të këtij aktgjykimi për demin material për ushqim të përforcuar është shumë adekuate dhe se e njëjta i përgjigjet edhe mendimit të ekspertëve mjekësor të cilët kanë konstatuar se ushqimi i përforcuar ishte i nevojshëm për 120 ditë e që gjykata e Apelit vlerëson se shumica prej 1,200.00 euro është e mjaftueshme. Andaj dhe vendosi që në këtë pjesë ta ndryshojë aktgjykimin e ankimuar.

Gjykata e Apelit vlerëson si të bazuar pretendimet ankimore të palëve ndërgjyqëse në lidhje shkeljet esenciale të procedurës kontestimore dhe vërtetim të gabuar të gjendjes faktike për pjesën e kompensimit të demit material për ndihmën e personit të tretë, fitimit të humbur, shpenzimet e terapisë fizikale si dhe shpenzimeve të shërimit, pasi që konsideron se aktgjykimi i ankimuar në këtë pjesë është i përfshirë në shkelje të neni 182 paragraf 2 pika n), për faktin se aktgjykimi i atakuar, ka të meta të atilla, për shkak të cilave, nuk mund të ekzaminohet. I njëjti aktgjykim nuk përmban arsye për faktet vendimtare në lidhje me demin material, të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes dhe ato pak arsye të cilat janë dhënë nga gjykata e shkallës së parë, janë të paqarta, kontradiktore dhe pa mbështetje në provat nga shkresat e lëndës. Nga arsyetimi i aktgjykimit nuk mund të kuptohet se cilat janë pretendimet e palëve lidhur me gjendjen faktike dhe cilat janë të gjeturat e gjykatës. Gjykata nuk ka specifikuar se cilat kanë qenë faktet vendimtare dhe në çfarë mënyre janë vërtetuar faktet e tilla, për të arritur deri te përfundimi mbi themelësinë e kërkesëpadisë së paditësit për demin material, arsyetimi i aktgjykimit të ankimuar për këtë pjesë të dispozitivit është kontradiktore me dispozitivin pasi që gjykata e shkallës së parë në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar ka vendosur në lidhje me lartësinë e arritur të demit material për ndihmën e personit të tretë si dhe fitimit të humbur në shumatat e cekura si në dispozitiv si dhe për periudhën e ardhshme në lartësinë e gjykuar, ndërsa në pjesën arsyetuese si dhe në elaborim të ekspertizës financiare ka arsyetuar edhe kamatën për shumën e arritur për dy kategoritë e demit, gjë që një mënyrë e tillë e vendosjes e bënë aktgjykimin të pa kuart dhe kontradiktore në mes vete.

Gjykata e Apelit i vlerëson si të bazuara pretendimet ankimore të paditësit dhe të paditurës në lidhje me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike sa i përket kompensimit të demit material për ndihmën e personit të tretë, fitimit të humbur, shpenzime të shërimit dhe shpenzimet e terapisë fizikale pasi që edhe gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë nuk e ka sqaruar mjaftueshëm nevojën e ndihmës së personit të tretë, pasi që në bazë të ekspertizave të administruara në këtë çështje kontestimore nuk është sqaruar mjaftueshëm fakti i ndihmës së personit të tretë sepse fillimisht ekspertët në ekspertizën e përpiluar me shkrim kanë përcaktuar se ndihma e personit të tretë ka qenë e nevojshme për 90 ditë, ndërsa në dëgjimin e ekspertit Dr. Sh. D., Neurokirurg, është theksuar se paditësi ka nevojë të kohëpaskohshme për personin e tretë edhe në të ardhmen pasi që të njëjtit i është paraqitur epilepsi post aksidental, mirëpo për gjykatën



e Apelit ky lloj i mendimit është i pa kjart dhe i pa qëndrueshëm pasi që nuk përmban sqarimet e nevojshme për të vërtetuar se si ka ardhë deri te ndryshimi i mendimet nga eksperti pasi që i njëjti në bazë të provave që gjinden në shkresa e lëndës ka dhënë mendim edhe në ekspertizën e përpiluar me shkrim dhe me të njëjtat prova ka dhënë edhe mendimin në seancë gjyqësore.

Gjithashtu gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar saktë se diagnoza e paditësit Epilepsi post aksident a është shkaktuar nga aksidenti apo i njëjti ka vuajtur nga e njëjta edhe para aksidentit dhe nuk është sqaruar fare se në çfarë mënyre mund të manifestohet tek paditësi, i njëjti a duhet që patjetër të shoqërohet nga një preson i tretë gjatë gjithë kohës apo ka nevojë për personin e tretë vetëm në momentin e krizave. Andaj, në këtë kuptim gjykata e shkallës së parë është dashur që të nxjerrë një ekspertizë të re me ekspert të fushës përkatëse me qëllim të vërtetimit të drejtë të këtyre dilemave pasi që sqarimit nga ekspertit aktual janë tejet të pa kjarta, pasi që nuk ka dhënë arsye në lidhje me shkakun shkakun e paraqitjes së kësaj s'mundje, të vërtetojë se paditësit a i duhet ndihma e personi të tretë gjatë gjithë kohës apo vetëm në raste të krizave.

Gjykata e Apelit vlerëson se duke mos vërtetuar në mënyrë të drejtë faktin e paraqitjes së sëmundjes epileptike tek paditësi, gjykata e shkallës së parë ka ardh deri te vërtetim i gabuar edhe i gjendjes faktike në lidhje me zvogëlimin e aktivitetit punues pasi që eksperti në ekspertizë ka specifikuar edhe këtë faktorë në zvogëlimin e aktivitetit punues. Andaj në këtë kuptim gjykata e shkallës së parë, pasi që të vërtetoj në tërësi gjendjen faktike në lidhje me sëmundjen epileptike tek paditësi, të thërras ekspertin e mjekësisë së punës për të plotësuar ekspertizën e tij në raport me të gjeturat e reja eventuale dhe eventualisht të caktoj në ekspertizë të re në lidhje me llogaritjen e lartësisë së fitimit të humbur si dhe lartësinë e ndihmës së personit të tretë duke u bazuar në prova materiale që gjinden në shkresat e lëndës si dhe provat shtesë që mund të nxirren në ri vendosje të kësaj çështje. Andaj, duke qenë se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, tani për tani edhe e drejta material është zbatuar në mënyrë të gabuar, ashtu që aktgjykimi i ankimuar për këtë pjesë është dashur të priset dhe çështjen e kthen në gjykatën e shkallës së parë në ri procedurë dhe ri vendosje. Andaj, Për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit jo të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe zbatimin të gabuar së drejta materiale, aktgjykimi i ankimuar në këtë pjesë u desh të priset dhe çështja të kthehet në ri procedurë dhe ri vendosje.

Udhëzohet gjykata e shkallës së parë që në ri procedurë të bëjë eliminimin e shkeljeve të sipër theksuara në atë mënyrë që të caktoj shqyrtimin kryesor dhe sipas propozimit të palëve të administrojë provat për vërtetimin e fakteve vendimtare, në atë mënyrë që të vërtetoj saktë shkaktari i paraqitjes së sëmundjes epileptike tek paditësi dhe varësisht nga rezultati i sajë të vërtetoj në tërësi se në çfarë mënyre nevojitet ndihma e personit të tretë si dhe të vërtetoj edhe të vlerësoj edhe një herë lartësinë e kompensimit për fitimin e humbur e gjithashtu të administroj edhe prova tjera në lidhje me shpenzimet e shërimit si dhe shpenzimet e terapisë fizikale, e pastaj përmes vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, të ketë mundësi që në mënyrë të drejtë dhe objektive të vlerësoj rrethanat e çështjes lëndore e pastaj të vendos në mënyrë meritore lidhur me kërkesëpadinë e paditësit për këto lloje të dëmit material dhe pa marrë parasysh cili do të jetë përfundimi lidhur me çështjen lëndore, të evitohet shkeljet procedurale të konstatuara si me lartë

nga gjykata ankimore, ashtu që vendimin të cilin do ta bie do duhet të përmbajë të gjitha elementet e kërkuara ligjore, siç përcaktohet me dispozitën e nenit 160 të LPK-së.

Gjykata e Apelit vendosi si në pikën II të këtij aktgjykimi sa i përket shpenzimeve të procedurës, pasi që gjykata e shkallës së parë në ri procedurë do të vendosë për të gjitha shpenzimet e krijuara si në shkallë të parë e po ashtu edhe shpenzimet e krijuara në ri procedurë.

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në bazë të nenit 195.1 pika c) dhe e), të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**

Ac.nr.7927/2021, me datën 12.03.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,  
Besnik Bislimaj, d.v